

SHOQERI ANONIME PA OFERTE PUBLIKE



Akti i Themelimit
TE
SHOQERISE

"SATELIT +" SH.A

"HAKANI & ASSOCIATES"

KONSULENCE DHE PERFAQESIM

Adresa: Rr. "Brigada VIII Shqiptese"
Pall. "Jeshil, Perballë "Inventil" kat. F. No 4
Tirane - Shqiperi
P.O. Box 2411
Tel.: +355 4240000
+355 4240001
Fax: +355 4253422

A K T T H E M E L I M I
I
SHOQERISE ANONIME
“SATELIT +” SH.A



Shqipëri, ditën e *martë*, me datë *21.09.2004* (dymije e kater), ne baze te ligjit nr. 7638, dt. 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, me cilesine e aksionereve themelues:

1. Shoqeria “Media 6” sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr.16941, dt.12.02.1997 te Gjykates Rrethit Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. *20.09.2004*, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Aleksander FRANGAJ, i biri Vasilit, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga “Dervish Hima” nr.1,
2. Shoqeria “TVA” sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 22058, dt. 04.10.1999 te Gjykates Rrethit Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. *20.09.2004*, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Artan SEVRANI, i biri i Fetahut, i dtl. 17.07.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga e Kavajes, pall.3, shk.1,
3. Shoqeria “Media 99” sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 23817, dt.17.05.2000 te Gjykates Shkalles Pare Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. *21.09.2004*, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Agim ZEZO, i biri Nazmiut, i dtl.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga “Dervish Hima”,

kane vendosur themelimin e shoqerise tregtare anonime pa oferte publike “SATELIT +” SH.A.

Me nenshkrimin e ketij akti themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruessit dhe themeluesit e saj marrin persiper te realizojne e te respektoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

Neni 1

Ne perputhje me kerkesat e ligjit shqiptar Nr.7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare”, krijohet shoqeria anonime pa oferte publike “SATELIT +” SH.A.

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Rruga “Dervish Hima” nr.1, Tirane, Shqiperi.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise anonime “SATELIT +” SH.A eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, por ky afat mund te nderpritet ne funksion te kompetencave te Asamblese se Aksionereve te shoqerise.

Neni 4

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, jashte ketij territori, ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi.

Neni 5

Themeluesit e Shoqerise "SATELIT +" S.H.A, njekohesisht Aksionere te saj, me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te shoqerise, marrin persiper qe te respektojne te gjitha detyrimet qe lindin ne ushrimin e aktivitetit te kesaj shoqerie dhe detyrimet qe rrjedhin nga statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 6

Shoqeria "SATELIT +" S.H.A, ka vulen e saj dalluese e cila e identifikon ate.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 leke dhe perbehet nga 200 aksione me vlere nominative 10 000 leke secili, te numertuar ne menyre progresive nga numri 1 deri tek numri 200. Te gjithe aksionet e shoqerise, pavaresisht nga numertimi, jane te barazvlefshem.

Pronesia mbi kapitalin themeltar te shoqerise eshte e te gjithe aksionereve themelues te saj dhe zoterohet si me poshte:

Shoqeria "Media 6" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Aleksander FRANGAJ, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,

Shoqeria "TVA" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Artan SEVRANI, zoteron 33.33% te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,

Shoqeria "Media 99" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Agim ZEQQO, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te Shtetit Shqiptar si dhe me realizimin e praktikës se plote perkatese administrative dhe ligjore kjo shoqeri gjate aktivitetit te saj mund te rrise apo te zvogeloje kapitalin e saj themeltar ne perputhje me procedurat e percaktuara ne Statutin e shoqerise dhe ne ligjin tregtar shqiptar.

Neni 8

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Shitja dhe blerja e te drejtave televizive, te filmave, programeve, dokumentareve, emisioneve, cikleve, aktiviteve te ndryshme sportive, spektakleve televizive dhe gjithcka qe ka te beje me prodhimtari ne fushen e medias elektronike dhe te shkruar, televizive apo kinematografike, qe mund te blihet apo te shitet.
- Publicitet dhe marketing ne fushen e reklamave, te auditimit spoteve publicitare, publikim, reklamim e organizim te fushatave publicitare te kompanive te ndryshme.
- Prodhim programesh te ndryshme tematike, televizive pa kufizim, me qellim shitjeje.
- Aktivitet tregtar nepermjet shit-blerjes se kartave te koduara si dhe sherbime ne fushen e marresave satelitore.

- Veprimtari ne fushen e eksport-importit; si tregtim te programeve televizive, kinematografike brenda dhe jasht vendit, tregtim me shumice e pakice, te pajisjeve elektronike dhe dixhitale (HI-FI) te produksionit televiziv ku perfshihen: vidiokaseta (VHS), audiokaseta (MC), kompaktdisqe (CD) per audio, video(DVD), mp3, kamera, monitore, video si dhe cdo pajisje tjeter qe sherben per realizimin e veprimtarive televizive.

➤ Organizim panairesh per ekspozimin e prodhimeve shqiptare apo te shoqerive te huaja, duke bere publicitet tregtar si dhe ruajtjen e ekskluzivitetit tregtar ne territorin e Shqiperise, ne bashkepunim me keta shoqeri.

- 8.2 Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter qe do te konsiderohet nga aksioneret e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise.

Neni 9

Organet drejtuese te shoqerise "SATELIT +" SH.A, jane:

- Mbledhja e Aksionereve (E zakonshme dhe e jashtezakonshme)
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

Keto organe drejtuese kane kompetencat e tyre dhe funksionojne sipas menyres se percaktuar ne statutin e shoqerise.

Neni 10 - Mbledhja e Asamblese se Shoqerise

Asambleja e Aksionereve mund te jete e Zakonshme apo e Jashtezakonshme sipas parashikimeve te Statutit dhe Ligjit Tregtar. Asambleja zakonisht mblidhet ne seline e shoqerise por mund te mblidhet edhe ne cdo vend tjeter vend tjeter qe gjykohet I pershtatshem nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres.

Mbledhja e Asamblese quhet e ligjshme ne rast se ploteson quorumin e percaktuar ne Statutin e shoqerise ne varesi te cilesimit te saj.

Neni 11 - Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme e aksionereve vendos per:

- Miratimin ose mos miratimin e bilancit financiar vjetor te shoqerise,
- Miratimin e planit ekonomik -financiar te shoqerise per vitin e ardhshem,
- Emerimin, zevendesimin, pezullimin ose shkarkimin e ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise, miratimin e raportit te paraqitur prej tij si dhe percaktimin e mases se shperblimit,
- Direktivat strategjike ne veprimtarine e shoqerise,
- Autorizon emetimin e obligacioneve dhe nxjerr akte te vecanta te sigurimit qe lidhen me to,
- Perdorimin e fitimit neto te shoqerise,
- Shperblime te organeve te shoqerise,
- Masen e dividendit qe do te shperndaht.

Asambleja e zakonshme e aksionereve kryen te gjitha veprimet qe jane te caktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare", akti i themelimit dhe ky statut, me perjashtim te kompetencave te cilesuara per asamblene e jashtezakonshme te aksionereve.

Asambleja e zakonshme i merr vendimet me shumice te thjeshte te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ne mbledhje. Barazimi ne votim sjell qe propozimi te rrezohet.

Neni 12 - Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme e aksionereve eshte i vetmi organ kompetent qe vendos

Ndryshime ne statutin dhe ne aktin e themelimit te shoqerise,

- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise,
- Zgjatjen e kohezgjatjes se shoqerise,
- Pushimin apo nderprejen e veprimtarise se shoqerise,
- Emerimin, zevendesimin, pezullimin ose shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise,
- Cenimin e aksioneve te kapitalit themeltar,
- Tjetersimin e aksioneve te shoqerise,
- Caktimin e likuidatorit,
- Shnderrimin e shoqerise anonime ne forma te tjera shoqerish,
- Cdo veprim te cilin ky Statut dhe ligji tregtar ia njeh ekskluzivisht.

Neni 13 - Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise per administrimin e shoqerise nga ana e saj.

Ne baze te ketij akti themelimi Keshilli Mbikqyres do te perbehet nga 3 anetare te cilet percaktohen ne Statutin e shoqerise. Numri i anetareve te Keshillit Mbikqyres mund te ndryshohet sipas situatave te krijuara ne shoqeri, kjo sipas percaktimeve te ligjit dhe statutit.

Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 3 vjet. Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te mos jene aksionere te shoqerise dhe jane te gjitha te rizgjedhshem. Ata mund te shkarkohen ne çdo moment nga asambleja e jashtezakonshme per shkaqe te perligjura.

Neni 14 - Drejtoria

Organi ekzekutiv i shoqerise eshte Drejtoria. Anetaret e drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise. Drejtoria ka kompetenca te plote per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise brenda tagrave te percaktuara ne statut. Anetaret e drejtorise emerohen per nje afat 2 vjeçar i cili eshte i rinovueshem pa kufizim. Emerimi i anetarit te drejtorise eshte ne papajtim me qenien njekohesisht anetar i Keshillit Mbikqyres. Ne rast te ketij emerimi, mandati i tij ne keshill merr fund me hyrjen e tij ne funksion. Anetaret e drejtorise mund te pezullohen nga Keshilli Mbikqyres, i cili mund te marre vete ne çdo kohe kompetencat e saj. Menyra dhe masa e shperblimit te anetareve te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

Neni 15

Ky Akt Themelimi hartohet ne Tirane ne 5 ekzemplare origjinale, duke patur secila te njejten vlere ligjore e kuptimore.

Neni 16

Themeluesit njekohesisht dhe Aksioneret e shoqerise pasi u njohen dhe kuptuan drejt te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt Themelues i Shoqerise "SATELIT +" SH.A, i cili shpreh dhe vullnetin e tyre e neshkruajne rregullisht ate.

Neni 17

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar apo personalitetin juridik, me regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates Shkalles Pare Tirane.

Neni 18

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve qe mund te lindin gjate zhvillimit te aktivitetit dhe interpretimin e akteve te shoqerise eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 19

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Aksioneret, dhe e vertetimit te firmave te tyre para noterit.

AKSIONERET THEMELUES


Per shoqerine "Media 6" sha

Aleksander Frangaj
ALEKSANDER FRANGAJ



Per shoqerine "TVA" sha

Artan Sevrani
ARTAN SEVRANI



Per shoqerine "Media 99" sha

Agim Zeqo
AGIM ZEQQ

Akti i Themelimit u hartua nga

"HAKANI & ASSOCIATES"

KONSULENCE DHE PERLAQESIM

Adresa: Rr. "Brigada VIII Shqipërisë",

qalë Veslir, Përbalicë "Ishveria", Kati I, Nr. 1

Tirane - Shqipëri

PO Box 2771

Tel: +355 42 40 050

Fax: +355 42 40 200

Fax: +355 42 43 422

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 NOTERIA E TIRANES
 Nr 6918 Rep
 Nr 442 Kol

NOTER
 TIRANE

VERTETIM

NOTERE

Sot me 21. 09. 2004 (Dy mije e kater), para meje noter **BLERINA AVRAZI** anetare e dhomes se Notereve Tirane, me adrese ne *Rr Durrës 204*, u paraqiten:

- Aleksander FRANGAJ, i biri Vasilit, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1, i identifikuar ne baze te pasaportes me nr. 0011396, perfaqesues me tagra te plota i shoqerise "Media 6" sha,
 - Artan SEVRANI, i biri i Fetahut, i dtl. 17.07.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga e Kavajes, pall.3, shk.1, i identifikuar ne baze te pasaportes me nr.1766709, perfaqesues me tagra te plota i shoqerise "TVA" sha,
 - Agim ZEZO, i biri Nazmiut, i vtl.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Dervish Hima", i identifikuar ne baze te pasaportes me nr.1760780, perfaqesues me tagra te plota i shoqerise "Media 99" sha,
- me cilesine e Aksionereve themelues te shoqerise "SATELIT +" SH.A, te cilet me deklaruan se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tyre te lire kane marre e formuluar **AKTIN E THEMELIMIT** te shoqerise "SATELIT +" SH.A, te cilin ua lexoj dhe e nenshkruajne ate rregullisht para meje.
- Une, noteri, konform ligjit e vertetoj ate.

PULLE TAKSE



NOTERI
 NOTERE
 BLERINA AVRAZI

Ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992
"PER SHOQERITE TREGTARE"



SHOQERI AKSIONERE PA OFERTE PUBLIKE

Statuti I Shoqerise

"SATELIT +" SH.A

"HAKANI & ASSOCIATES"

KONSULENCE DHE PERFAQESIM

Adresa: Rr. "Brigada VIII Shqiptese",
Pall. "Jeshil, Perballe "Juvenilja", Kat. I, No. 4
Tirane - Shqiperi
P.O. Box 2411
Tel: +355 4240200
+355 4240201
Fax: +355 4253422



STATUTI I SHOQERISE ANONIME "SATELIT +" SH.A

KAPITULLI I – DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Emertimi

- 1.1 Krijohet shoqeria anonime "SATELIT +" SH.A. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjithe regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.
- 1.2 Shoqeria "SATELIT +" SH.A, eshte shoqeri anonime pa oferte publike.
- 1.3 Shoqeria ka vulen e saj identifikuese, ne formen dhe ekstremitetet e saj.

Neni 2

Aksioneret


Shoqeria krijohet ne marreveshje (kontrate) te aksionereve te shoqerise te cilet jane:

1. Shoqeria "Media 6" sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr.16941, dt.12.02.1997 te Gjykates Rrethit Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. 20.09.04, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Aleksander FRANGAJ, i biri Vasilit, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1,
2. Shoqeria "TVA" sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 22058, dt. 04.10.1999 te Gjykates Rrethit Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. 20.09.04, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Artan SEVRANI, i biri i Fetahut, i dtl. 17.07.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga e Kavajes, pall.3, shk.1,
3. Shoqeria "Media 99" sha, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 23817, dt.17.05.2000 te Gjykates Shkalles Pare Tirane, e perfaqesuar me tagra te plota per te vepruar ne emer dhe per llogari te saj ne baze te vendimit dt. 21.09.04, te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise nga z. Agim ZEQQO, i biri Nazmiut, i vtl.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Dervish Hima",

Neni 3

Objekti I shoqerise

- 3.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
 - Shitja dhe blerja e te drejtave televizive, te filmave, programeve, dokumentareve, emisioneve, cikleve, aktiviteteve te ndryshme sportive, spektakleve televizive dhe gjithcka qe ka te beje me prodhimtari ne fushen e medias elektronike dhe te shkruar, televizive apo kinematografike, qe mund te blihet apo te shitet.
 - Publicitet dhe marketing ne fushen e reklamave, te auditimit spoteve publicitare, publikim, reklamim e organizim te fushatave publicitare te kompanive te ndryshme.



Prodhim programesh te ndryshme tematike, televizive pa kufizim, me qellim shitjeje. Aktivitet tregtar nepermjet shit-blerjes se kartave te koduara si dhe sherbime ne fushen e marresave satelitore.

Veprimtari ne fushen e eksport-importit; si tregtim te programeve televizive, kinematografike brenda dhe jasht vendit, tregtim me shumice e pakice, te pajisjeve elektronike dhe dixhitale (HI-FI) te produksionit televiziv ku perfshihen: vidiokaseta (VHS), audiokaseta (MC), kompaktdisqe (CD) per audio, video(DVD), mp3, kamera, monitore, video si dhe cdo pajisje tjeter qe sherben per realizimin e veprimtarive televizive.

- Organizim panairesh per ekspozimin e prodhimeve shqiptare apo te shoqerive te huaja, duke bere publicitet tregtar si dhe ruajtjen e ekskluzivitetit tregtar ne territorin e Shqiperise, ne bashkepunim me keta shoqeri.

3.2 Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter qe do te konsiderohet nga aksioneret e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise.

Neni 4

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise do te jete ne Rruga “Dervish Hima” nr.1, Tirane. Shoqeria mund te hape filjale, perfaqsi apo dege ne te gjitha teritorin e Shqiperise. Ne varsi te aktivitetit, ato mund te kene dhe qendrat e tyre legale.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise anonime “SATELIT +” SHA eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, por ky afat mund te nderpritet ne funksion te kompetencave te Asamblese se Aksionereve te shoqerise, dhe ne baze te ligjit tregtar.

Neni 6

Shtrirja e aktivitetit

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise, jashte ketij territori, ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi.

KAPITULLI II – KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET, AKSIONERET


Neni 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar I shoqerise eshte 2 000 000 leke dhe perbehet nga 200 aksione me vlere nominative 10 000 leke secili, te numertuar ne menyre progresive nga numri 1 deri tek numri 200. Te gjitha aksionet e shoqerise, pavaresisht nga numertimi, jane te barazvlefshem.

7.2 Numertimi I aksioneve ka vlere indikative dhe nuk sherben per te treguar perparesine ne shlyerje apo ne likuidim.

7.3 Pronesia mbi kapitalin themeltar te shoqerise eshte si me poshte:
Shoqeria “Media 6” sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Aleksander FRANGAJ, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,



Shoqeria "TVA" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Artan SEVRANI, zoteron 33.33% te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,
Shoqeria "Media 99" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Agim ZEZO, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione.

Neni 8

Depozitimi I kapitalit

- 8.1 Kapitali themeltar shlyhet plotesisht nga aksioneret apo perfaqesuesit e tyre ne perpjestim me pjeset takuese te secilit aksioner perpara regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar.
- 8.2 Ne mbledhjen e tij te pare, e cila mbahet detyrimisht brenda tre muajve nga dita e regjistrimit, Keshilli Mbikqyres I shoqerise konstaton shlyerjen e rregullt te kapitalit te shoqerise dhe shqyrton vlefshmerine e te gjitha praktiketes se krijimit te shoqerise.

Neni 9

Ndryshimi I kapitalit themeltar

- 9.1 Kapitali themeltar I shoqerise mund te shtohet apo te pakesohet vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve. Ne çdo rast, ndryshimi I kapitalit themeltar te shoqerise duhet te jete I arsyetuar dhe I shoqeruar me relacionin e Ekspertit Kontabel te shoqerise.
- 9.2 Procedurat per ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise duhet te fillojne brenda tre muajsh nga dita e marrjes se vendimit nga Asambleja e Jashtezakonshme, perndryshe jane te pavlefshme.

Neni 10

Menyrat e shtimit te kapitalit themeltar

- 10.1 Shtimi I kapitalit themeltar te shoqerise behet ne nje nga menytrat e meposhtme:
 - a) me emetimin e aksioneve te reja, duke shtuar numrin e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise pa ndryshuar vleren nominale te aksionit.
 - b) me rritjen e vleres nominale te çdo aksioni pa ndryshuar numrin e pergjithshem te tyre.
- 10.2 Kompetent per caktimin e menyres se shtimit te kapitalit themeltar eshte Asambleja e Jashtezakonshme pasi merr ne shqyrtim relacionin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.
- 10.3 Aksionet e reja shlyhen me para ne dore, me kompesim te nje kredie te kerkueshme te shprehur ne para, me perfshirje te rezervave, fitimeve apo primeve apo me kontribut ne natyre.
- 10.4 Zmadhimi I kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanim te aksionereve me perjashtim te rastit kur realizohet me perfshirjen e rezervave, fitimeve apo primeve te emetimit.

Neni 11

E drejta e perparesisë gjate shtimit te kapitalit themeltar

- 11.1 Aksionet japin te drejte perparesisë ne nenshkrimin per rritjen e kapitalit. Aksioneret kane te drejte perparesisë ne nenshkrimin per rritjen e kapitalit ne proporcion me aksionet qe zoterojne.
- 11.2 Afati per ushtrimin e te drejtes se perparesisë caktohet nga Keshilli Mbikqyres I shoqerise dhe nuk mund te jete me pak se tre muaj. Ne rast se nje aksioner deklaroi perpara afatit te caktuar se heq dore nga ushtrimi I kesaj te drejte, ky afat nuk respektohet.



Neni 12

Kontributet ne natyre

- 12.1 Ne rastin e kontributeve ne natyre caktohen me vendim gjyqesor nje ose disa eksperte per percaktimin e vleres se kontributeve. Raporti I tyre vihet ne dispozicion te aksionereve te pakten 8 dite perpara mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme.
- 12.2 Ne rast se asambleja miraton vleresimin e kontributeve ajo merr njekohesisht vendimin per evidentimin e rritjes se kapitalit.
- 12.3 Ne rast se asambleja zvogelon vleren e percaktuar nga eksperti atehere ajo kerkon miratimin me shkrim te kontribuesit ne natyre apo perfaqsesit te tij ligjor, ne te kundert zmadhimi I kapitalit nuk realizohet.

Neni 13

Pakesimi I kapitalit themeltar

- 13.1 Kapitali themeltar I shoqerise mund te zvogelohet vetem me vendim te Asambles se Jashtezakonshme, vetem pasi te jete shqyrtuar paraprakisht relacioni I Ekspertit Kontabel te Autorizuar lidhur me kete ceshtje.
- 13.2 Ne te gjithë rastet zvogelimi I prek aksioneret te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne.
- 13.3 Blerja e aksioneve te veta eshte e ndaluar nga shoqeria, por ne rastin e zvogelimit te kapitalit themeltar te pajustificuar nga humbjet Asambleja mund te autorizojë Drejtorine te bleje ne emer te shoqerise aksione te sajat per t'i anuluar.
- 13.4 Kapitali themeltar nuk mund te pakesohet poshte kufirit minimal ligjor te parashikuar ne ligjin tregtar.

Neni 14

Karakteret I Aksioneve

- 14.1 Aksionet dhe te drejtat qe lindin prej tyre jane nominale dhe te pandashme. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej nje aksioni ndjekin titullin e pronesise se tij.
- 14.2 Aksionet jane lirisht te transferueshme midis aksionereve te shoqerise. Aksionet mund te tjetersohen tek te tretet vetem pasi te jete ushtruar negativisht e drejta e perparemise e aksionereve te shoqerise sipas nenit 11/2 te ketij Statuti.

Neni 15

Te drejtat dhe detyrimet e aksionereve

- 15.1 Pronesia mbi aksionet prezumon pranimin e Statutit dhe akteve te tjera te shoqerise dhe vendimeve te organeve te saj.
- 15.2 Aksioneret kane te drejte te marrin pjese ne fitimin neto te shoqerise ne perputhje me aksionet qe zoterojne dhe mund ta ushtrojne kete te drejte ne perputhje me vendimet e organeve drejtuese te shoqerise.
- 15.3 Aksioneret pergjigjen vetem deri ne nivelin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.

Neni 16

Perfaqesimi I aksionereve ne shoqeri

- 16.1 Aksioneret kane te drejte te ushtrojne te gjitha te drejtat qe kane ne shoqeri sipas ligjit dhe Statutit personalisht apo nepermjet perfaqsesve te tyre.
- 16.2 Ne çdo rast vlefshmeria e perfaqesimit shqyrtohet nga Kryetari I Keshillt Mbikqyres.

16.3 Perfaqesimi ne asamble i percaktuar ne statut eshte i barazvlefshem me ate te vendosur ne vijim nga aksioneret dhe mund te ndryshohet perkatesisht nga secili aksioner sipas dispozitave te statuteve perkatese te tyre. Ndryshimi i perfaqesimit ne asamble nuk konsiderohet si ndryshim statuti.

KAPITULLI III – DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 17

Organet Drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise "SATELIT +" SH.A, jane:

- Mbledhja e Aksionereve (E zakonshme dhe e jashtezakonshme)
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

Neni 18

Asambleja e Aksionereve

18.1 Asambleja e Aksionereve eshte organi me I larte drejtues I shoqerise dhe ka te drejte per te vendosur ne lidhje me te gjitha ceshtjet e shoqerise. Ajo ka te drejte te shqyrtoje vlefshmerine e çdo vendimi te Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorise dhe kur eshte rasti t'i anulloje ato kur nuk jane ne perputhje me Statutin dhe ligjin.

18.2 Asambleja e Aksionereve perfaqeson totalin e kapitalit te shoqerise dhe vendimet e saj detyrojne dhe angazhojne te gjitha aksioneret, edhe kur ata nuk jane pjesmarres ne vendimmarrje apo jane kunder vendimeve te Asamblese.


18.3 Asambleja e aksionereve mblidhet ne formen e Asamblese se Jashtezakonshme sa here qe Keshilli Mbikqyres e therret si te tille apo sa here qe I jep vetes kete cilesim. Vetem Asambleja e Jashtezakonshme ka te kompetence te marre vendime qe ndryshojne Statutin e shoqerise apo çdo dispozite te tij. Kur merr kete cilesim Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime vetem sipas kuorumit te percaktuar ne nenin 23.2 te ketij Statuti.

18.4 ASAMBLEJA E ZAKONSHME e Aksionereve, vendos per:

- Miratimin ose mos miratimin e bilancit financiar vjetor te shoqerise,
- Miratimin e planit ekonomik –financiar te shoqerise per vitin e ardhshem,
- Emerimin, zevendesimin, pezullimin ose shkarkimin e ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise, miratimin e raportit te paraqitur prej tij si dhe percaktimin e mases se shperblimit,
- Direktivat strategjike ne veprimtarine e shoqerise,
- Autorizon emetimin e obligacioneve dhe nxjerr akte te veçanta te sigurimit qe lidhen me to,
- Perdorimin e fitimit neto te shoqerise,
- Shperblime te organeve te shoqerise,
- Masen e dividendit qe do te shperndahet.

18.5 ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME e Aksionereve eshte organ i vetem kompetent qe vendos ne lidhje me:

- Ndryshime ne statutin dhe ne aktin e themelimit te shoqerise,
- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise,
- Zgjatjen e kohezgjatjes se shoqerise,
- Pushimin apo nderprejen e veprimtarise se shoqerise,



Emerimin, zevendesimin, pezullimin ose shkarkimin e anetareve te Keshillit

Mbikqyres te shoqerise,

Cenimin e aksioneve te kapitalit themeltar

Shpjetersimin e aksioneve te shoqerise

Qaktimin e likuidatorit

Shnderrimin e shoqerise anonime ne forma te tjera shoqerish.

Cdo veprim te cilin ky Statut dhe ligji tregtar ia njeh ekskluzivisht

18.6 Asambleja e Aksionereve mundet ne çdo kohe te revokojë vendimet e saj kur ato nuk jane regjistruar ne Regjistrin Tregtar.

Neni 19

Thirrja e Asamblese

- 19.1 Asambleja e Aksionereve thirret nga Keshilli Mbikqyres dhe mblidhet rregullisht te pakten nje here per çdo vit financiar brenda 6 muajve nga perfundimi I tij. Si raste perjashtimore, Asambleja mund te mblidhet kur thirret nga Drejtoria, Eksperti Kontabel, I ngarkuari nga gjykata, sipas dispozitave te ketij Statuti dhe ligjit tregtar.
- 19.2 Asambleja e Jashtezakonshme mblidhet sa here qe e gjykon te arsyeshme Keshilli Mbikqyres apo sa here qe kerkohet nga aksioneret qe zoterojne te pakten 10 % te kapitalit themeltar. Ne kete rast kerkesa I drejtohet Kryetarit te Keshillit Mbikqyres se shoqerise, I cili vendos per kohen dhe vendin e mbledhjes.
- 19.3 Asambleja mblidhet si rregull ne seline e shoqerise, por mund te mblidhet edhe ne cdo vend tjeter vend tjeter qe gjykohet I pershtatshem nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres.
- 19.4 Thirrja e Asamblese duhet te permbaje kohen dhe vendin ku do te zhvillohet mbledhja dhe rendin e dites te formuluar qarte dhe kur eshte rasti nje kopje te materialeve qe do te shqyrtohen. Thirrja e Asamblese duhet tu komunikohet aksionereve apo perfaqsesve te tyre ne rruge zyrtare ku te konfirmohet marrja dijeni te pakten 15 dite perpara zhvillimit te mbledhjes.
- 19.5 Thirrja e asamblese ne kundërshtim me keto procedura eshte e pavlefshme dhe nuk ka fuqi vendim-marrese.

Neni 20

Pjesmarrja ne mbledhjen e asamblese

- 20.1 Çdo aksioner qe zoteron te pakten nje aksion mund te marre pjese me te drejte vote ne mbledhjen e asamblese ose te caktojë nje perfaqesues te tij. Akti I perfaqesimit duhet te jete I noterizuar dhe ne rastet kur eshte I perpiluar jashte vendit duhet edhe te legalizohet dhe duhet te permbaje ne menyre te shprehur qarte tagrat te cilat ka perfaqesuesi.
- 20.2 Mbledhja e asamblese drejtohet nga kryetari I Keshillit Mbikqyres.

Neni 21

E drejta e votes

Çdo aksion I jep zoteruesit te tij te drejten e nje vote. Aksioneret shprehin me voten e tyre vetem nje qendrim per te gjithë aksionet qe zoterojne. Totali I aksioneve qe zoteron nje aksioner nuk mund te ndahet per efekt votimi ne pjese.

Neni 22

Kuorumi i nevojshem

22.1 Mbledhja e zakonshme e Asamblese merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem ne qofte se aksioneret e pranishem zoterojne te pakten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj kuorumi.

22.2 Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe ne te dyten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Ne raste te mos arritjes te ketij kuorumi mbledhja e dyte mund te shtyhet per nje date te mevonshme, jo me te larget se dy muaj nga data e thirrjes se pare.

22.3 Ne çdo rast kuorumi verifikohet para fillimit te mbledhjes nga kryetari I Keshillit Mbikqyres se shoqerise.

Neni 23

Marrja e vendimeve te asamblese

23.1 Asambleja merr vendime te vlefshme vetem per çeshtjet e percaktuara paraprakisht ne rendin e dites. Vendimet e Asamblese merren me shumice absolute te votave te pjesmarresve.

23.2 Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme merren me $\frac{3}{4}$ e votave te pjesmarresve.

23.3 Vendimet qe kane te bejne me probleme te rendesishme qe mund te dalin gjate funksionimit te shoqerise, do te merren me pjesemarrje dhe raporte perfaqesimi sipas parashikimeve te ligjit tregtar.

Neni 24

Menyra e votimit

Si rregull votimi behet I hapur, por asambleja mund te vendose perpara çdo votimi per menyren e zhvillimit te tij.

Neni 25

Kontrolli financiar i Asamblese

25.1 Drejtoria I paraqet Asamblese llogarite vjetore dhe kur eshte rasti llogarite e konsoliduara.

25.2 Ekspertet kontabel paraqesin perpara asamblese kryerjen e detyrave te tyre te ngarkuara sipas ligjit.

25.3 Asambleja shqyrton dhe vendos per te gjitha çeshtjet financiare te vitit te kaluar.

Neni 26

Procesverbali i mbledhjeve te asamblese

Mbledhjet e Asamblese pasqyrohen ne procesverbal dhe mbahen ne nje liber te veçante. Çdo aksioner ka te drejte qe te kerkoje qe mendimet e tij te pasqyrohen saktesisht ne procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali nenshkruhet nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres dhe Sekretari I mbledhjes. Çdo aksioner ka te drejte ne çdo kohe te njihet me permbajtjen e nje procesverbali.

Neni 27

Keshilli Mbikqyres

27.1 Keshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare te cilet mund te mos jene aksionere te shoqerise. Mandati I anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte 3 (tre) vjeçar dhe mund te rinovohet pa kufizim.

27.2 Kur vendi I nje anetari mbetet bosh drejtoria duhet te therrase urgjentisht mbledhjen e asamblese per te plotesuar efektivin e Keshillit Mbikqyres. Zevendesuesi qendron ne detyre deri ne emerimin e Keshillit te ri Mbikqyres.

27.3 Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te jene njekohesisht anetare te Drejtorise.

27.4 Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te jene njekohesisht perfaqesues te aksionereve ne Asamble.

27.5 Per here te pare anetaret e Keshillit Mbikqyres zgjidhen ne mbledhjen themeluese te shoqerise nga Asambleja e Aksionereve.

27.6 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve mund te zevendesoje ne çdo kohe nje anetar apo te gjithë Keshillin Mbikqyres pa qene e detyruar te motivoje vendimin e saj.

Neni 28

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

28.1 Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Drejtoria I paraqet Keshillit raport te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar Drejtoria I paraqet Keshillit Mbikqyres te gjithë dokumentat qe lidhen me mbylljen e vitit financiar.

28.2 Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryhej ne çdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe I gjykon te arsyeshme dhe te njihet me dokumentet qe I konsideron te nevojshme ne punen e tij.

28.3 Keshilli Mbikqyres ka kompetenca te plota te lidhi ne emer te shoqerise marreveshje konsulence apo perfaqesimi per te patur asistencen e nevojshme ligjore gjate ushtrimit te pergjegjesive te veta.

28.4 Ne çdo rast Keshilli Mbikqyres mund te pezulloje kompetencat e drejtorise dhe t'i ushtroje vete ato.

28.5 Keshilli Mbikqyres emerone dhe mund te shkarkoje per shkaqe te perligjura anetaret e drejtorise. Perjashtohen rastet kur shkarkimi eshte nxitur haptazi nga shkaqe qe s'kane te bejne me shoqerine. Shkarkimi mbetet ne fuqi deri sa vendimi gjyqesor qe konstaton pavlefshmerine e shkarkimit te tij, te marre forme te prere.

Neni 29

Marreveshje qe kerkojne autorizim

29.1 Nuk mund te lidhen pa autorizimin paraprak te Keshillit Mbikqyres:

a) te gjitha marreveshjet midis shoqerise dhe nje anetari te drejtorise apo te keshillit mbikqyres apo nje personi te trete I lidhur direkt apo indirekt me ta.

b) marreveshjet midis shoqerise dhe nje personi tjeter juridik kur njeri nga anetaret e drejtorise apo keshillit mbikqyres eshte ortak I pakufizuar, administrator apo anetar I drejtorise I subjektit tjeter.

29.2 Gjate shqyrtimit te ketyre marreveshjeve anetari I keshillit qe rezulton I lidhur me subjektin tjeter nuk ka te drejte vote.

29.3 Autorizimi mund te jepet vetem pasi te merret mendimi I Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

29.4 Rregullat e ketij neni nuk zbatohen per marreveshjet e bera per operacionet e perditshme dhe te zbatuara ne kushte normale.

Neni 30

Thirrja e Keshillit Mbikqyres

- 30.1 Keshilli Mbikqyres mblidhet te pakten nje here ne tre muaj ne mbledhje te rregullt dhe aq here sa e gjykon te arsyeshme Kryetari apo zevendesi i caktuar prej tij ne menyre te jashtezakonshme.
- 30.2 Keshilli Mbikqyres mblidhet me kerkesen e Drejtorise.
- 30.3 Keshilli eshte I detyruar te mblidhet ne rast se kerkohet nga 2 anetareve te tij.

Neni 31

Kuorumi I Keshillit Mbikqyres

- 31.1 Keshilli Mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme, pa qene e pranishme te pakten gjysma e antareve te tij.
- 31.2 Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me shumice absolute votash. Kur numri I votave te pjesmarresve eshte I barabarte, vota e Kryetarit eshte percaktuese.

Neni 32

Proces verbali i mbledhjes

Vendimet e marra nga Keshilli Mbikqyres mbahen ne nje liber te vecante dhe neshkruhen nga anetaret prezent. Çdo anetar ka te drejte te kerkoje te shkruhet ne liber mendimi I tij i kundert.

Neni 33

Drejtoria

- 33.1 Drejtoria perbehet nga nje anetar, i cili eshte Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise.
- 33.2 Nuk lejohet qe anetaret e drejtorise te jete njekohesisht anetare te Keshillit Mbikqyres.
- 33.3 Anetaret e drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres.

Neni 34

Kompetencat e Drejtorise

- 34.1 Drejtoria ka kompetence te plote per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise brenda tagrave te percaktuara ne statut Ajo ushtron kete kompetence brenda objektit te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca te cilat I jepen nga ligji tregtar apo ky Statut shprehimisht Keshillit Mbikqyres apo Asamblese se aksionereve.
- 34.2 Drejtoria eshte e pavarur ne vendim-marrjen e saj te brendshme ne shoqeri lidhur me ate pjese te aktivitetit qe mbulon si pasoje e ndarjes administrative te detyrave per organizimin e aktivitetit te perditshem te shoqerise.
- 34.3 Drejtoria nuk mund te disponoje mbi pronat e shoqerise te luajtshme apo te paluajtshme pa miratimin e shprehur te Keshillit Mbikqyres apo kur eshte rasti te Asamblese se Aksionereve.

Neni 35

Perfaqesimi tek te tretet

Drejtoria perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Neni 36

Pergjegjesia e Drejtorise

- 36.1 Drejtoria eshte e detyruar te ruaje sekretet e Shoqerise per te cilat vihet ne dijeni gjate ushtrimit te detyres.



36.2 Kur nga veprimet apo mosveprimet e anetareve te drejtorise ne mosperputhje me ligjin apo me kete Statut I shkaktohet nje dem material apo moral shoqerise, ata pergjigjen civilisht per demin e shkaktuar ne menyre te pakufizuar.

Neni 37

Mandati i Drejtorise

37.1 Anetaret e drejtorise caktohen ne detyre per nje afat 2 vjeçar me te drejte te pakufizuar rinovimi. Ne rast se vendi mbetet bosh zevendesuesi emerohet per periudhen qe mbetet deri ne emerimin e drejtorise se re.

37.2 Menyra dhe masa e shperblimit te secilit anetar te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne momentin e emerimit.

Neni 38

Ndalimi I huadhenies

Anetaret e drejtorise dhe anetaret e keshillit mbikqyres, pervec atyre qe jane persona juridike, ndalohen te kontraktojne ne cilendo forme qe te marrin hua nga shoqeria, te japin nepermjet saj paradhenie, si dhe te behen dorezanes apo te garantojne nepermjet saj detyrimet e te treteve.

KAPITULLI IV – EKSPERTI KONTABEL, VITI FINANCIAR

Neni 39

Ekspertet Kontabel

39.1 Ne shoqeri kontrolli ushtrohet nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar. Eksperti Kontabel caktohet me vendim te Asamblese se Aksionereve dhe duhet te plotesoje kushtet e nevojshme ligjore per te qene I tille.

39.2 Ekspertet emerohen per nje vit financiar.

39.3 Çdo aksioner ka te drejte qe ne rastet kur shoqeria mbetet pa ekspert kontabel apo ligji kerkon emerimin e nje eksperti tjetër, dhe ky detyrim nuk eshte plotesuar nga Asambleja, t'i kerkoje gjykates caktimin e nje eksperti kontabel te autorizuar ne rruge gjyqesore.

39.4 Eksperti Kontabel I shoqerise eshte I detyruar te ruaje sekretet per te cilat vihet ne dijeni gjate ushtrimit te profesionit dhe eshte pergjegjes per demet qe I shkakton shoqerise nga veprimet apo mosveprimet me faj te tij.

Neni 40

Detyrat e ekspertit kontabel

40.1 Eksperti kontabel I autorizuar garanton rregullshmerine e llogarive vjetore dhe te gjendjes financiare te shoqerise, te verifikojë librat e llogarise dhe fondet e shoqerise, te kontrolloje pershtatjen e kontabilitetit me legjislacionin ne fuqi dhe sigurojne qe te jete respektuar barazia midis aksionereve, si dhe çdo detyre tjetër qe rrjedh shprehimisht nga ligji tregtar shqiptar apo I ngarkohet me vendim te asamblese.

40.2 Eksperti ushtron kompetencat e tij dhe mban pergjegjesite qe rrjedhin nga kryerja e detyres ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe ligjit tregtar shqiptar.

Neni 41

Informimi I organeve te shoqerise

Eksperti kontabel I autorizuar u ben te njohur Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorise:

a) kontrollet qe ka kryer dhe verifikimet qe ka bere

- b) pjeset e bilancit dhe dokumentave kontabel ne te cilat duhet te behen ndryshime se bashku me verejtjet perkatese
- c) pa rregullshmerite dhe pasaktesite e zbuluara
- d) perfundimet qe rrjedhin nga verejtjet dhe korrigjimet te krahasuara me rezultatet e vitit financiar te meparshem.

Neni 42

Te drejtat e ekspertit

42.1 Eksperti pervec sa I njihet nga ligji per ushtrimin e detyres ka te drejte:

- a) qe ne mbarim te afatit te funksioneve, kur eshte propozuar shkarkimi I tij, te degjohet nga Mbledhja e Asamblese se aksionereve.
- b) te marre pjese ne mbledhjet e drejtorise e cila mbyll llogarite e vitit te kaluar financiar
- c) si rast perjashtimor, eksperti kontabel ka te drejte qe per ceshtje ne te cilat eshte drejtperdrejte pergjegjes t'i kerkoje Keshillit Mbikqyres te therrase mbledhjen e Asamblese, I cili eshte I detyruar qe brenda 10 diteve te filloje procedurat e thirrjes.

42.2 Shperblimi I ekspertit kontabel caktohet nga Drejtoria me baze mujore apo per cdo sherbim, parashikohet si shpenzim I veçante dhe perballohet nga shoqeria.

Neni 43

Ushtrimi i vitit financiar

43.1 Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

43.2 Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar gjer me 31 Dhjetor.

Neni 44

Inventari dhe llogarite vjetore

44.1 Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

44.2 Ne mbyllje te ushtrimit, Drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.

Neni 45

Raportet Vjetore

45.1 Ne mbylljen e cdo viti financiar Drejtoria ben inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per Keshillin Mbikqyres.

45.2 Bilancit I bashkangjiten nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

45.3 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme, etj.

45.4 Nje kopje e ketij raporti I jepet Ekspertit Kontabel per miratim.

Neni 46

Rezultatet e ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

46.1 Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire ne keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

46.2 Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave perfaqeson dividentin, i cili i shperndahehet aksionereve.

12

46.3 Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

46.4 Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per tu perfshire ne fitimet e ushtrimeve te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 47

Rezerva e domosdoshme

47.1 Nga fitimi I rezervuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit te meparshem, hiqet menjane nje shume e barabarte me 1/20 e fitimit e destinuar per formimin e fondit reserve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

47.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye cfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 e kapitalit.

47.3 Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, shoqeria do te heqe jo me shume se 85% per krijimin e rezervave per zhvillim apo te tjera rezerva te nevojshme.

Neni 48

Fitimi qe shperndahet

Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Aksionereve sipas raportit te Keshillit Mbikqyres dhe Ekspertit Kontabel ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

KAPITULLI V – PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 49

Prishja e shoqerise (para kohe)

49.1 Shoqeria priset ne rast humbje te gjysmes se kapitalit themeltar.

49.2 Shoqeria priset automatikisht me perfundimin e afatit n.q.s ka kohezgjatje te percaktuar ne statut.

49.3 Shoqeria priset me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, me nje kuorum prej ¾ te votave te pjesmarresve.

Neni 50

Likuidimi I shoqerise

50.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise para kohe, asambleja e aksionereve cakton nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.

50.2 Likuidatori i emeruar nga asambleja menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikojne bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe tua ve ne dispozicion aksionereve me kerkesen e tyre.

50.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Drejtorise dhe ato i kalojne likuidatorit.

50.4 Gjate procesit te likuidimit aksioneret ruajne te njejtat te drejta informimi si dhe me pare.

KAPITULLI VI – DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 51

Dispozite kalimtare

Vlera e kapitalit themeltar te shoqerise eshte shlyer nga aksioneret ne perputhje me aksionet qe zoterojne perpara firmosjes se ketij Statuti.

Neni 52

Keshilli I pare Mbikqyres

Keshilli I pare Mbikqyres, sipas vendimit te Asamblese se Aksionereve dt.

do te perbehet nga:

Artan SEVRANI, i biri i Fetahut, i dtl. 17.07.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga e Kavajes, pall.3, shk.1, *me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres*,

Agim ZEQQO, i biri Nazmiut, i vtl.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Dervish Hima", *me cilesine e anetarit*,

Marsel SKENDO, i biri Zagollit, i dtl. 06.12.1949 lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1, *me cilesine e anetarit*,

Neni 53

Drejtoria

Drejtoria e pare, sipas vendimit te Keshillit Mbikqyres te shoqerise me dt.

do te perbehet nga nje anetar:

Aleksander FRANGAJ, i biri Vasilit, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1, *me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem*,

Neni 54

Eksperti i pare Kontabel

Ekspert Kontabel i pare i shoqerise sipas vendimit te Asamblese se Aksionereve dt.

caktohet:

Bujar OSMANI, i biri Maliqit, i vtl. 1965, me adrese ne: Rruga "Mine Peza" nr. 82, Tirane, me nr. licence 70, dt. 10.02.2000.

Neni 55

Dispozita te fundit

55.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

55.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

55.3 Pavlefshmerite e dispozitave te vecanta te Statutit nuk cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 56

Gjykata kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis aksionereve dhe interpretimin e statutit te shoqerise eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 57

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga aksioneret, para nje noteri publik.




AKSIONERET THEMELUES

Per shoqerine "Media 6" sha

Aleksander Frangaj
ALEKSANDER FRANGAJ

Per shoqerine "TVA" sha

Artan Sevrani
ARTAN SEVRANI



Per shoqerine "Media 99" sha

Agim Zeqo
AGIM ZEZO

Statuti i shoqerise u formulua nga

"HAKANI & ASSOCIATES"
KONSULENCE DHE PERFAQESIM
Adresa: Rr. "Brigada VIII Sulmuese",
Pall. Jeshil, Perballë "Juvencija", Kat. I, No.4
Phone - Shqiptari
P.O.Box 7411
Tel. +355 4240200
+355 4240201
Fax +355 4253422

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr 6019 Rep
Nr 443 Kol

VERTETIM

**NOTERE
BLERINA AVRAZI**

Sot me 21.09.2004 (Dy mije e kater), para meje noteres anetare e
dhomes se Notereve Tirane, me adrese ne ,u paraqiten:
-Aleksander FRANGAJ, i biri Vasilit, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne
Tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1, i identifikuar ne baze te pasaportes me nr.
0011396, perfaqesues me tagra te plota i shoqerise "Media 6" sha,
-Artan SEVRANI, i biri i Fetahut, i dtl. 17.07.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne
adresen: Rruga e Kavajes, pall.3, shk.1, i identifikuar ne baze te pasaportes me nr.1766709,
perfaqesues me tagra te plota i shoqerise "TVA" sha,
-Agim ZEZO, i biri Nazmiut, i vtl.1968, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane ne adresen:
Rruga "Dervish Hima", i identifikuar ne baze te pasaportes me nr.1760780, perfaqesues me
tagra te plota i shoqerise "Media 99" sha,
me cilesine e Aksionereve themelues te shoqerise "SATELIT +" SH.A, te cilet me
deklaruan se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tyre te lire kane marre e formuluar
STATUTIN e shoqerise "SATELIT +" SH.A, te cilin ua lektoj dhe e nenshkruajne ate
regullisht para meje.
Une, noteri, konfirm ligjit e vertetoj ate.

NOTERI

**NOTERE
BLERINA AVRAZI**



Organizim panairesh per ekspozimin e prodhimeve shqiptare apo te shoqerive te huaja, duke bere publicitet tregtar si dhe ruajtjen e ekskluzivitetit tregtar ne territorin e Shqiperise, ne bashkepunim me keta shoqeri.

Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjetër qe do te konsiderohet nga aksioneret e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise.

Shoqeria do te kete emertimin: Shoqeria anonime "SATELIT +" SH.A.
Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Rruga "Dervish Hima" nr.1, Tirane.

Shoqeria do te vazhdoje aktivitetin e saj pa afat te percaktuar.
Kapitali themeltar i shoqerise "SATELIT +" SH.A, eshte 2 000 000 leke dhe perbehet nga 200 aksione me vlere nominative 10 000 leke secili. Te gjitha aksionet e kapitalit themeltar te shoqerise jane te barazvlefshme.

Aksioneret dhe pronesia mbi kapitalin themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

- Shoqeria "Media 6" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Aleksander FRANGAJ, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,
- Shoqeria "TVA" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Artan SEVRANI, zoteron 33.33% te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione,
- Shoqeria "Media 99" sha, e perfaqesuar me tagra te plota nga z. Agim ZEQQ, zoteron 33.33% te kapitalit themeltar te shoqerise ose 66.666 aksione.

Organet Drejtuese te Shoqerise "SATELIT +" SH.A, jane:

- Mbledhja e Aksionereve (E zakonshme dhe e jashtezakonshme)
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

Keshilli i pare Mbikqyres i shoqerise perbehet nga tre anetare, perkatesisht:

- Artan SEVRANI, me cilesine e kryetarit,
- Agim ZEQQ, me cilesine e anetarit, (zevendoson kryetarin ne mungese te tij)
- Marsel SKENDO, me cilesine e anetarit,

Drejtoria e pare e shoqerise perbehet nga nje anetar:

- Aleksander FRANGAJ, me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem,

Ekspert kontabel i autorizuar i shoqerise eshte caktuar:


- Bujar OSMANI, i biri Maliqit, i vtl. 1965, me adrese ne: Rruga "Mine Peza" nr. 82, Tirane, me nr. licence 70, dt. 10.02.2000



Bashkangjitur kerkeses dokumentacioni perkates:

- Akti I themelimit
- Statuti I shoqerise
- Vendimi i Asamblese themeluese te Aksionereve dt. 21. 09.04, per emerimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres te shoqerise dhe caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar.
- Vendimi i Keshillit Mbikqyres per zgjedhjen e kryetarit dhe per emerimin e Drejtorise se shoqerise dt. 21. 09.04.
- Vendimi dt. 20. 09.04 i Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Media 6" sha, per caktimin e z. Aleksander FRANGAJ si perfaqesues te shoqerise.
- Vendimi dt. 21. 09.04 i Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Media 99" sha, per caktimin e z. Agim ZEZO si perfaqesues te shoqerise.
- Vendimi dt. 20. 09.04 i Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "TVA" sha, per caktimin e z. Artan SEVRANI si perfaqesues te shoqerise.
- Licenca e ekspertit me nr.70 date 10.02.2000
- Vertetimi i pageses se vleres te kapitalit themeltar

KERKUES


Aleksander FRANGAJ
Drejtor i Pergjithshem i shoqerise
"SATELIT +" SH.A

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANES
Nr. 6017 Rep
Nr. - Kol

VERTETIM

Sot ne Tirane, ditën e mejte, me 21. 09. 2004 (Dy mije e kater) para meje noterit

NOTERE

, anetar i Dhomes se Notereve Tirane, ne adresen: Rr. Dervish Hima,

BLERINA AVRAZI, u paraqit:

Aleksander FRANGAJ, i biri Vasil, i dtl. 10.04.1968, lindur ne Lezhe dhe banues ne tirane ne adresen Rruga "Dervish Hima" nr.1, madhor, i panjohur personalisht prej meje, per identitetin e te cilit u njoha nga dokumentat identifikues qe me paraqiti, me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise anonime "SATELIT +" SH.A, i cili me deklaroi se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij te lire e te plote ka formuluar kete **KERKESE** per regjistrimin si person juridik te shoqerise "SATELIT +" SH.A drejtuar Gjykates Shkalles Pare Tirane. Une noterit pasi ia lexoj me ze te larte, e nenshkruan rregullisht para meje ate dhe une noterit e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TA



R. SHQIPERISE

NOTERI
NOTERE
BLERINA AVRAZI